



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr.2008/6 prot.

Tiranë, më 21.7.2023

REKOMANDIM

Nr. 34, datë 21.7.2023

PËR KONTROLLUESIN “NIKI MARE SH.P.K.”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Niki Mare sh.p.k.” (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 97, datë 30.06.2023 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- *Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga subjekti i të dhënave B. A., në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS L51802506P dhe ushtron veprimtarinë si agjenci turistike, udhëtimi dhe detare spedicionere. Organizim eventesh dhe manifestimesh publicitare. Dhënie me qira e anijeve dhe jahteve me vela dhe me motor me/pa ekuipazh (blerje, qira, administrim, i anijeve) për llogari të vet dhe të të tretëve, shërbim konsulencë dhe edukim

profesional për sektorin e turizmit. Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare mbi pasuritë e luajtshme apo të paluajtshme që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektivave të shoqërisë si dhe mund të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërisë të tjera që kanë objekt të ngjashëm apo të përafërt.

Në kuadër të veprimtarisë që kryen, “Niki Mare sh.p.k.” përpunon të dhëna personale për kategoritë, “vizitorë”, “nëpunës”, “pasagjerë”. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Pranë Zyrës së Komisionerit është paraqitur një ankesë, përmes së cilës, ankuesi ngre pretendime lidhur me një përhapje të paligjshme të të dhënave personale të pasagjerëve. Përhapja e të dhënave personale konsiston në një dokument të printuar në përmbajtje të të cilit ndodhet një tabelë me listën e pasagjerëve e që përmban kategoritë e të dhënave: “emër” mbiemër”, “shtetësia”, “datëlindja”, “vendbanimi”, “numri i pasaportës”, “kodi i udhëtimit”, “data e udhëtimit” dhe “trageti”. Rezulton se tabela përmban të dhëna të përmbledhura për pasagjerët e dy linjave të transportit detar, Grandi Navi Veloci S.P.A. (në vijim, “GNV”) dhe Adria Ferries.

Nga verifikimi i dokumentacionit, rezulton se “Niki Mare sh.p.k.” (në cilësinë e agentit), ka lidhur kontratë me shoqërinë GNV (në cilësinë e pronarit), qëllimi i së cilës, ndër të tjera është kryerja e aktivitetit në portin e Durrësit, të asistojë anijet, të hipë dhe zbresë pasagjerët, të lëshojë bileta udhëtarësh, etj. Në kuptim të pikës 5, të nenit 3, pikës 2/c dhe pikës 3 të nenit 4 të ligjit, “Niki Mare sh.p.k.”, gëzon cilësinë e kontrolluesit. Në këtë kuadër, parashikimet e Ligjit, që zbatohen nga kontrolluesit, zbatohen edhe për përfaqësuesit e tyre.

Rezulton se sistemi elektronik në të cilin veprojnë punonjësit e “Niki Mare shpk” mban logon e shoqërisë GNV dhe aksesohet nëpërmjet një “webservice” nga ana e operatorëve të “Niki Mare sh.p.k.”, të cilët janë të pajisur me kredencialet e veta “emër përdoruesi” dhe “fjalëkalimin” përkatës. Gjithashtu, referuar aneksit B, të amendamentit nr. 9 të kontratës bazë, të lidhur midis GNV dhe “Niki Mare sh.p.k.”, rezulton se pajisjet kompjuterike, “firewall”, VPN, çdo pajisje hardware, si dhe linja e dedikuar e internetit, janë në pronësi dhe kontrollohen/administrohen nga shoqëria GNV.

Moduli i Sistemit të GNV, për agjencinë detare “Niki Mare sh.p.k.”, aksesohet “on line” dhe hapet/aktivizohet vetëm nga ana e GNV për çdo nisje në orën 17.30 dhe mbyllet në orën 23:00, me nisjen e anijes.

Proceset e punës të shoqërisë “Niki Mare sh.p.k.”, konsistojnë në: mbarëvajtjen e procesit të ngarkimit dhe shkarkimit të pasagjerëve dhe mallrave, asistencën e ekuipazhit në proceset e ndryshme që kryhen në portin e Durrësit, si dhe përgatitja dhe dorëzimi i dokumentacionit që nevojitet gjatë këtyre proceseve.

Përveç proceseve operative të ngarkim - shkarkimit dhe procedurave të tjera në port, agjencia detare “Niki Mare shpk” kryen edhe dy funksione të tjera, që janë:

- a) Shoqëria është përgjegjëse për ngarkimin dhe shkarkimin e mjeteve të transportit me mallra, përgatitjen e regjistrimit të tyre në sistemin e shoqërisë GNV, si dhe përgatitjen e manifestit me të dhënat e këtyre mjeteve dhe mallrave.
- b) Në pjesën e imbarkimit dhe zbarkimit të pasagjerëve dhe veturave, agjencia është përgjegjëse për “*check in*”-in e tyre, pajisjen me “*boarding pass*”, si dhe gjenerimin e listave të tyre nga sistemi i shoqërisë GNV.

Në sektorin e pasagjerëve, çdo pasagjer që udhëton me traget, paraqitet pranë sportelit GNV të agjencisë “Niki Mare sh.p.k.”, për të kryer procesin e “*check in*” dhe pajisjen me “*boarding pass*”, pa të cilat nuk mund të kryhet imbarkimi.

Në rast se pasagjeri nuk ka pasur mundësi të pajiset me biletë jashtë portit ose “*on line*”, atëherë agjencia “Niki Mare sh.p.k.” ka të drejtë (njësoj si një agjenci udhëtimi), për të furnizuar me biletë udhëtimi pasagjerët. Të dhënat e pasagjerit për t’u pajisur me biletë, regjistrohen në një modul të veçantë të sistemit të GNV, nga punonjësit e “Niki Mare sh.p.k.”.

3. Nga verifikimi në sistem, rezultojnë se kategoritë e të dhënave, të cilat regjistrohen për qëllim të gjenerimit të biletës, janë: “*emër, mbiemër, gjinia, i rritur/fëmijë, ditëlindja, vendlindja, shtetësia, numri i dokumentit, kodi i udhëtimit/biletës (GNxxx/AFxxx), data e udhëtimit (tranzit), import/export*”.

Rezultojnë se përpara se anija të niset nga porti i Durrësit, të dhënat e mësipërme eksportohen nga sistemi i GNV, në format elektronik “*.pdf*” (për autoritetet italiane, edhe në formatet “*.csv*” dhe “*.xml*”). Më pas të dhënat nisen nëpërmjet postës elektronike bookdurazzo@gnv.com (që është email i krijuar nën domainin e GNV për t’u përdorur nga “Niki Mare shpk”), drejtuar: Policisë së Shtetit Italian, Portit të Barit, Guardia di Finanza, Agjencisë Detare në Bari, Dogana di Bari, Mjekësisë Ligjore, Kapitenerisë së Portit të Barit, Guardia Costiera, Policisë Kufitare të Durrësit, Doganës së Durrësit, Kapitenerisë së Durrësit, Autoritetit Portual të Durrësit dhe Operatorit Shqiptar të Terminalit të Tragetëve (AFTO).

Vendosja në dispozicion e listës së pasagjerëve drejt autoriteteve të sipërcituara, kryhet në bazë të Kodit Detar, Kodit Doganor, ligjit nr. 108/2014 “Për policinë e shtetit”, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore për transportin detar të mallrave dhe pasagjerëve, në bazë të të cilave institucionet veprojnë.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit, deklaroi se këto dokumenta, në përmbajtje të të cilave ndodhen listat e pasagjerëve, i printon edhe anija në bord, me qëllim për të verifikuar pasagjerët që imbarkohen, si dhe me mbërritjen në portin destinacion, i paraqet pranë autoriteteve përgjegjëse për verifikim.

Nga verifikimet në sistemin elektronik të GNV, si dhe dokumentacioni i vendosur në dispozicion, në kuadër të hetimit administrativ rezulton se, nuk është përcaktuar një afat kohor konkret për ruajtjen e të dhënave personale të pasagjerëve. Mospërcaktimi i një afati kohor konkret për ruajtjen e të dhënave të pasagjerëve, është në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale, të parashikuara në germën “d” të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me kategoritë e të dhënave të grumbulluara në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, Kontrolluesi duhet të parashikojë mbajtjen e të dhënave personale të grumbulluara në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër se sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin të dhënat janë grumbulluar, në përputhje me parashikimin e germës “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

4. Nga shqyrtimi i provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ, të cilat konsistojnë në: provat e vendosura në dispozicion të Zyrës së Komisionerit nga ankuesi; verifikimi dhe dokumentimi i listave të pasagjerëve në sistemin GNV; verifikimi i operatorëve që realizojnë procesin e “check in”; komunikimet nëpërmjet postës elektronike të “Niki Mare shpk” me autoritetet kompetente (lidhur me informimin mbi listat e pasagjerëve), si dhe deklaratimet e përfaqësuesve të “Niki Mare shpk”, rezulton se pasagjerët në përbërje të listës, për të cilën ankuesi pretendon përhapje të paligjshme të të dhënave, kanë udhëtuar në datën 09.05.2023, me itinerar Bari-Durrës, nëpërmjet tragetit GNV. Nga ana tjetër, referuar provave të vendosura në dispozicion nga ankuesi, rezulton se ky i fundit ka udhëtuar nëpërmjet tragetit GNV, me itinerar Durrës-Bari, më datë 14.05.2023.

Mbështetur në provat, konstatimet në vend, si dhe verifikimet e proceseve përpunuese, Zyra e Komisionerit arriti në konkluzionin se nuk u provua se përhapja e të dhënave të pasagjerëve në formatin e printuar, të ketë ardhur si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të punonjësve të shoqërisë “Niki Mare shpk”.

5. Nga verifikimi paraprak i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, në protokollin e Zyrës së Komisionerit, si dhe konstatimi gjatë hetimit administrativ të ushtruar, rezultoi se Kontrolluesi “Niki Mare shpk” nuk ka përmbushur detyrimin për Njoftim, në zbatim të nenit 21 të Ligjit. Megjithatë, ky detyrim është përmbushur nga “Niki Mare sh.p.k.” përgjatë procesit të hetimit administrativ. Konkretisht, Njoftimi është dërguar nëpërmjet postës elektronike më datë 12.07.2023.

Zyra e Komisionerit vlerëson reagimin e menjëhershëm nga ana e Kontrolluesit, mbi marrjen e masave për plotësimin e këtij detyrimi, si dhe thekson se procesi i “Njoftimit” është dinamik dhe kërkon një angazhim të vazhdueshëm nga Kontrolluesi për përditësimin e tij, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen qartësisht mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore, sipas parashikimeve të nenit 21 dhe 22 të Ligjit.

6. Kontrolluesi nuk disponon një “Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve, etj., sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese që Kontrolluesi kryen.

Megjithatë, në kuadër të marrjes së masave teknike dhe organizative, si dhe detyrimit për sigurinë e të dhënave, “Niki Mare sh.p.k.” disponon disa dokumente, anekse të kontratës bazë me shoqërinë GNV, të tilla si:

- a) Amendamenti nr. 9, ndërmjet GNV S.P.A. dhe Niki Mare sh.p.k., nëpërmjet të cilës, dakordësohet zgjatja e marrëveshjes aktuale, deri në periudhën 31.12.2023;
- b) Marrëveshja për përpunimin e të dhënave (DPA), sipas aneksit A;
- c) Kërkesat për sigurinë kibernetike, sipas aneksit B.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një rregulloreje specifike “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, për të mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Nga ana tjetër, rezulton se “Niki Mare shpk” nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, sikurse është parashikuar edhe në pikën 3, të aneksit B “Kërkesat për sigurinë kibernetike”.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, trajnimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përshtatura sipas nevojave dhe proceseve të punës të Kontrolluesit dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim ndërgjegjësimin e punonjësve të cilët për shkak të proceseve të punës, janë të ngarkuar për përpunimin e të dhënave personale.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vendosur në dispozicion Kontrolluesit.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesit e Kontrolluesit janë paraqitur në seancën dëgjimore, të datës 19.07.2023 të organizuar nga Zyra e Komisionerit dhe kanë deklaruar angazhim për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ të ushtruar.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit, gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5, 21, 27, 29, 30, 31 (pika 1, germa “a/l”), si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, të marrë masa për përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, për të gjitha proceset e përpunimit, në përputhje me germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit;
2. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje në zbatim të nenit 21 të Ligjit, të “Njoftojë” Zyrën e Komisionerit, për ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës;
3. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të hartojë rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, në të cilën të përfshijë masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi që kryen, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj..
4. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, të zbatojë detyrimet e përcaktuara në nenin 27 të Ligjit, lidhur me trajnimin e stafit të tij;
5. Në zbatim të pikës 1, të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti, brenda afateve, si vijon:
 - (i) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimin e treguar në pikën 1, më sipër;
 - (ii) vazhdimisht, detyrimin e treguar në pikën 2 më sipër;
 - (iii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimin e treguar në pikën 3 më sipër;
 - (iv) brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimin e treguar në pikën 4 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijani të këtij akti;

6. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;

7. Në rast mospërbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2, të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 21.7.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi